

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Haga dënoi krerët e UÇK, reagon Albin Kurti: Padrejtësi e papranueshme! Të korrigohet në apel – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/haga-denoi-kreret-e-uck-reagon-albin-kurti-padrejttesi-e-papranueshme/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 12:33:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 12:30:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d8ec583a98f4abb700a64f313180373ce4094acb9e223020b243ad07c91edfaa
TEKSTI	5566aabe535440422ce9e6ceaf109dd4b76162039ff9003ca22decba016ff659
PAMJA	29d20c008edfaf3270e56b429b82e22e14a7c7d338eb098e10ba57d890db4d0d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9cf559884dbc1b9b9f528578a1715076e36274d6070a11c488eb9fcf2a3dfb7a
E MËPARSHMJA	f0fd87e29af988ff3379e7a3ef210653dfd556ea24c175de1bc21db719355928
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9cf559884dbc1b9b9f528578a1715076e36274d6070a11c488eb9fcf2a3dfb7a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Kurti, ka reaguar duke e cilësuar vendimin si të padrejtë. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi u dënuan me gjithsej 81 vite burgim për akuza për krime lufte.

Ish-presidenti Hashim Thaçi është dënua me 25 vite burgim, Jakup Krasniqi me 25 vite, Kadri Veseli me 18 vite, ndërsa Rexhep Selimi me 13 vite burgim. Në reagimin e tij, Kurti ka thënë se aktgjykimi nuk duhet të shihet si përfundimtar dhe ka shprehur pritjen që ai të shqyrtohet dhe të korrigjohet në shkallën e apelit.

Sipas Kurtit, edhe pse aktgjykimi është shqiptuar formalisht në emër të popullit të Kosovës, kjo, nuk duhet të interpretohet si shprehje e vullnetit të qytetarëve të Kosovës.

“Ky aktgjykim patjetër duhet ndryshuar dhe korrigjuar në shkallën e apelit dhe më parë”, ka deklaruar Kurti, duke shprehur njëkohësisht mbështetjen për familjet e ish-krerëve të UÇK-së dhe bashkëluftëtarët e tyre.

Në reagimin e tij, kryeministri i Kosovës i është referuar edhe historikut të procesit që çoi në themelimin e Dhomave të Specializuara.

Kurti ka përmendur debatet në Këshillin e Evropës dhe akuzat e ngritura ndër vite ndaj UÇK-së, duke theksuar veçanërisht pretendimet për “Shtëpinë e Verdhë” dhe trafikimin e organeve. Sipas tij, këto pretendime nuk janë ngritur nga vetë Prokuroria në formën e akuzave, për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme.

Ai ka argumentuar gjithashtu se aktgjykimi i sotëm nuk e ka mbështetur

5 Këngëtarja e famshme flet hapur për sherrin me motrën e saj: Nuk ka asnjë...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

pretendimin se UÇK-ja kishte kryer një sulm të gjerë dhe sistematik kundër një popullsie civile.

Kurti ka theksuar se procesi gjyqësor, sipas tij, nuk duhet të interpretohet si gjykim i legjitimitetit apo i karakterit të përgjithshëm të luftës së UÇK-së.

Ai ka thënë se përfundimet dënuese lidhen me akuza të caktuara për krime lufte, përfshirë torturën dhe trajtimin e personave të konsideruar bashkëpunëtorë të regjimit serb.

“Përfundimet dënuese lidhen me akuza të caktuara për krime lufte, përfshirë torturën e personave të konsideruar bashkëpunëtorë të regjimit serb”, ka shkruar Kurti, duke shtuar se këto përfundime, sipas tij, nuk janë përfundimtare dhe do t’i nënshtrohen shqyrtimit në apel.

Kurti ka bërë të ditur se Qeveria e Kosovës do të vazhdojë mbështetjen institucionale për katër të dënuarit gjatë procedurës së apelit.

“Siç kemi bërë prej fillimit të këtij procesi, Qeveria do të vazhdojë, me të gjitha mjetet që i ka në dispozicion, t’i mbështesë të akuzuarit në procesin e apelit”, ka deklaruar Kurti.

Kurti ka deklaruar se UÇK-ja lindi si përgjigje ndaj shtypjes dhe se karakteri i saj historik, sipas tij, nuk mund të ndryshohet nga një proces gjyqësor.

“UÇK-ja nuk ishte zgjedhja e një populli që kërkonte luftë, por përgjigjja e një populli që, i shtypur dhe i kërcënuar në vetë ekzistencën e tij, kërkonte liri”, ka shkruar Kurti.

Ai ka theksuar se asnjë vuajtje njerëzore nuk duhet mohuar apo zvogëluar, por ka kundërshtuar që përgjegjësia për veprime të caktuara të përdoret, sipas tij, për të gjykuar në tërësi luftën e UÇK-së.

Në reagimin e tij, Kurti ka kritikuar edhe mënyrën e funksionimit dhe mandatin të Dhomave të Specializuara.

Ai ka thënë se institucioni është përqendruar në përgjegjësinë penale të pjesëtarëve të një pale të luftës, ndërsa krimet e kryera nga aparati shtetëror serb, sipas tij, nuk janë trajtuar në të njëjtin kuadër juridik.

“Kur në bankën e të akuzuarve gjenden vetëm pjesëtarët e një etnie, ndërsa aparati shtetëror që kreu masakra, dëbime dhe krime gjenocidale mbetet jashtë juridiksionit, krijohet në mënyrë të pashmangshme pamja e një drejtësie njëetnike”, ka shkruar Kurti.

Ai ka ngritur shqetësime edhe lidhur me transparencën e procesit, duke argumentuar se zhvillimi i pjesëve të procedurës larg publikut ka ndikuar në perceptimin për institucionin.

Sipas Kurtit, një mekanizëm ku përgjegjësia penale përqendrohet vetëm te pjesëtarët e një komuniteti, ndërsa krimet e palës tjetër nuk ndiqen në të njëjtin juridiksion, ngre çështje mbi barazinë para ligjit dhe perceptimin e paanshmërisë.

Në përmbyllje të reagimit, Kurti ka përsëritur se institucionet e Kosovës do të vazhdojnë mbështetjen për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin në procedurën e apelit.

“Kosova do të vazhdojë të mbështesë Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin e Jakup Krasniqin në procedurën e apelit, në mbrojtje të plotë, dinjitoze dhe institucionale”, ka deklaruar ai.

Aktgjykimi ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së nuk është përfundimtar dhe palët kanë të drejtë ta kundërshtojnë atë përmes procedurave të apelit.

#AlbinKurti

#Hage

#kosove

#UCK



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Më shumë video



VIDEO

Serbia gëzon për dënimin me 81 vite...

Xhuljana Zhuleku

49 minuta më parë



VIDEO

"UÇK-ja krenaria e popullit tonë", Vjosa...

Xhuljana Zhuleku

57 minuta më parë



VIDEO

Dënimi me 81 vite burgim për krerët e...

Xhuljana Zhuleku

1 orë më parë

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.